

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting**

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 19.01.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKCAK-</u> PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Klara shpk ka blerë 80% të aksioneve të Dora shpk më 1 qershor 2017. Pasqyrat e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2018 janë si në vijim:

	<i>Klara shpk</i>	<i>Dora shpk</i>
	€'000	€'000
Të hyrat nga shitja	8,400	3,200
Kosto e mallrave të shitura	(4,600)	(1,700)
Fitimi bruto	3,800	1,500
Shpenzimet operative	<u>(2,200)</u>	<u>(960)</u>
Fitimi para tatimit	1,600	540
Tatimi	(600)	(140)
Fitimi neto i vitit	1,000	400

Gjatë vitit Klara shpk i ka shitur mallra me kosto prej €1,000,000 kompanisë Dora shpk në shumë prej €1,500,000. Më 31 maj 2018 30% e këtyre mallrave ishin në stoqet e Dora shpk.

Kërkohet

- (a) Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2018.
(15 pikë)
- (b) Cila nga formulat paraqet shumën e cila paraqitet në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave si “Fitimi i shpërndarë për: Mbajtësit e ekuitetit për të kompanisë mëmë Klara shpk”?
A Fitimi i grupit pas tatimit – interesi jo kontrollues
B Fitimi i grupit pas tatimit + interesi jo kontrollues
C Fitimi pas tatimit i Klara shpk
D Fitimi i grupit pas tatimit
(2 pikë)
- (c) Cila është shuma e interesit jo kontrollues, cila duhet të paraqitet në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave?
(3 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 1

1 (a) Grupi Klara

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 maj 2018

	€'000
Të hyrat(8,400 + 3,200 - 1,500)	10,100
Kosto e shitjes (4,600 + 1,700 - 1,500 + 150)	(4,950)
Fitimi bruto	5,150
Shpenzimet operative (2,200 + 960))	<u>(3,160)</u>
Fitimi para tatimit	1,990
Tatimi (600 + 140)	<u>(740)</u>
Fitimi neto	1,250

(b) A

(c) Interesi jo-kontrollues = €80,000 (€400,000 × 20%)

Problemi 2

Beta kompani është një kompani e përfshirë në ndërtimin e fermave në Kosovë. Pronari ka kërkuar ndihmë nga ju në lidhje me regjistrimet në kontabilitet sa i përket pasurisë së patundshme, impijanteve të prodhimit dhe pajisjeve për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015.

Kanë ndodhur kostot e paraqitura si në vijim:

	€
Përgatitja e vendit	80,000
Mirëmbajtja vjetore pasi që pasuria bëhet funksionale	30,000
Trajnimi i stafit për të operuar me pasurinë pasi që ajo bëhet funksionale	25,000
Pagesat e importit për materialet e blera	28,000
Vrojtimi fillestar i vendit ku do të përfundohet pasuria	40,000
Paga e manaxherit të projektit për të ndërtuar dhe menaxhuar fermën	140,000
Pagat e punëtorëve për të ndërtuar fermën	300,000
Pagat e punëtorëve pasi që ferma hyn në funksion	100,000
Kostot e testimit	60,000
Zbritjet e marra në blerjen e materialeve	33,000

Kërkohet:

- (a) Kalkuloni shumën e saktë e cila duhet të kapitalizohet dhe të paraqitet si pasuri në bazë të kërkesave të *SNK 16 Pasuritë e patundshme, impijantet e prodhimit dhe pajisjet*

(10 pikë)

- (B) Ndërtesa e zyrës e Beta kompani është ndërtesa e vetme në pronësi të kësaj kompanie. Nga vlerësuesit profesional, kjo ndërtesë është rivlerësuar më 1 Janar 2015, me shumën prej €2,100,000. Jeta e përdorimit të kësaj pasurie nuk ka ndryshuar pas rivlerësimit. Kjo ndërtesë është blerë më 1 Janar 2005. Kosto e blerjes ishte €2,500,000 dhe zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2014 ishte €500,000. Është përdorur metoda drejtvizore e zhvlerësimit. Vlerësuesi profesional vlerëson se vlera e mbetur e kësaj ndërtese në fund të jetës së përdorimit do të jetë €600,000.

Kërkohet:

Në përputhje me *SNK 16 Pasuritë e patundshme, impijantet e prodhimit dhe pajisjet* :

- (i) Kalkuloni zhvlerësimin për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 dhe regjistroni në kontabilitet rivlerësimin e pasurisë më 1 janar 2015 si dhe regjistroni zhvlerësimin vjetor më 31 dhjetor 2015.

(10 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 2

(a)

	€		€
Përgatitja e vendit	80,000	Po	80,000
Mirëmbajtja vjetore pasi që pasuria bëhet funksionale	30,000	Jo	
Trajnimi i stafit për të operuar me pasurinë pasi që ajo bëhet funksionale	25,000	Jo	
Pagesat e importit për materialet e blera	28,000	Po	28,000
Vrojtimi fillestar i vendit ku do të përfundohet pasuria	40,000	Po	40,000
Paga e manaxherit të projektit për të ndërtuar dhe menaxhuar	140,000	Po	140,000
Pagat e punëtorëve për të ndërtuar fermën	300,000	Po	300,000
Pagat e punëtorëve pasi që ferma hyn në funksion	100,000	Jo	
Kostot e testimit	60,000	Po	60,000
Zbritjet e marra në blerjen e materialeve	33,000	Po	-33,000
Shuma e kapitalizimit			615,000

(10 pikë)

(b)
(i)

Kalkulimet

	€	
Kosto	2,500,000	
- Zhvlerësimi i akumuluar	-500,000	
Vlera neto në libra më 1 Janar 2015	2,000,000	
Rezerva e rivlerësimit	100,000	
	2,100,000	
Zhvlerësimi vjetor i ndërtesave - shënimi 1	-37,500	
Vlera neto në libra më 31 dhjetor 2015	2,062,500	
Shënimi 1		
Ndërtesat - kosto		2,500,000
Ndërtesat - Zhvlerësimi i akumuluar		500,000
Zhvlerësimi i akumuluar / Koston = 20%		

Me qenë se në të dhënat e detyrës nuk është dhënë jetëgjatësia e ndërtesës nga shuma e zhvlerësimit të akumuluar prej 500,000 ($500,000/2,500,000 * 100 = 20\%$) shihet se ndërtesa në total është zhvlerësuar prej 20%. Ky zhvlerësim ka qenë i grumbulluar prej datës 1/1/2005 - 1/01/2015, pra gjithsej 10 vite. Në mënyrë që zhvlerësimi të bëhet 100% kjo do të jetë $20\% * 5 = 100\%$. Kështu e tërë jetëgjatësia e ndërtesës është $10 \text{ vite} * 5 = 50 \text{ vite}$. Jeta e mbetur e ndërtesës pas rivlerësimit është 40 vite.

Zhvlerësimi vjetor pas rivlerësimit = $\frac{\text{Kosto} - \text{Vlera e mbetur}}{\text{Vitet}} = \frac{2,100,000 - 600,000}{40}$
 = 37,500

Regjistrimi i rivlerësimit

Debi: Zhvlerësimi i akumuluar	500,000	
Kredi: Ndërtesat-Kosto	400,000	(2,500,000-2,100,000)
Kredi: Rezerva e rivlerësimit	100,000	

Regjistrimi i zhvlerësimit

Debi: Shpenzimet e zhvlerësimit	37,500	
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar		37,500

(10 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Problemi 3

Kompania Okton shpk, (kompani e teknologjisë informative) ka kërkuar nga këshilla profesionale nga ju, në lidhje me trajtimin në kontabilitet të disa transaksioneve që kanë ndodhur pas datës së bilancit të gjendjes më 31 dhjetor 2016.

Pjesa A

Kërkohe:

- (a) Në përputhje me *SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese*, shpjegoni çka nënkuptohet me "Ngjarjet pas periudhës raportuese". (3 pikë)
- (b) Nëse një kompani merr informacion pas periudhës raportuese rreth kushteve që ekzistojnë në fund të periudhës raportuese, shpjegoni se si duhet të trajtohen këto informata në pasqyrat financiare. (2 pikë)

Pjesa B:

Kanë dalë në pah ngjarjet si në vijim për kompaninë Okton shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016.

- (i) Kompania ka patur një investim të vlerësuar me 200,000 eur në pasqyrat e veta financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Për shkak të frikës nga kriza financiare, investimit i ka rënë vlera në 180,000 eur më 10 janar 2017.
- (ii) Kompania ka blerë një automjet më 30 dhjetor 2016 dhe ka paguar një depozitë fillestare prej 5,000 eur në atë datë. Gjithashtu ka lëshuar një çek në shumë prej 20,000 eur, të cilin ja ka dërguar shitësit. Shitësi e ka pranuar dhe ka arkëtuar çekun më 3 janar 2017.
- (iii) Kompania Okton u padit nga një klient i cili ishte i pakënaqur me cilësinë e produktit që iu dorëzua në qershor të vitit 2016. Rasti i gjykatës u dëgjua në fund të tetorit 2016 por deri më 8 janar 2017 gjyqtari nuk ishte se vendosi në favor të Okton shpk për t'ia mbuluar shpenzimet juridike prej 20,000 eur. Kostot ligjore u paguan nga klienti i Okton më 12 janar 2017. Okton shpk ishte i pasigurt se do të fitojë rastin dhe kishte përfshirë më parë një provizion në pasqyrat e tij financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 për kompensimin dhe shpenzimet ligjore si në vijim

Debi Shpenzimet ligjore- Shpenzimet administrative	25,000	
Debi Kosto e shitjes	35,000	
Kredi Provizionet -Detyrime		60,000

- (iv) Njëri nga klientët e Okton shpk ka falimentuar më 5 janar 2017, i cili ka patur borxh prej 4,000 eur ndaj Okton shpk.

Kërkohe: Këshilloni menaxhmentin e Okton shpk mbi trajtimet e duhura në kontabiliteti për secilin rast veç e veç, për të bërë të sigurt se janë plotësuar kërkesat e SNK 10. Pra tregoni cila është ngjarje korigjuese dhe cila jo korigjuese.

(15 pikë)
[Totali: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 3

RAPORT

PËR: Kontrolluesin financiar - Okton shpk

NGA: Asistenti i kontabilistit financiar

Re: SNK 10- Ngjarjet pas periudhës raportuese

Data: Gusht 2017

Pjesa A

(a) Paragrafi 3 i SNK 10 thekson se ngjarjet pas periudhës raportuese janë ato ngjarje, të favorshme dhe të pafavorshme, që ndodhin ndërmjet fundit të periudhës raportuese dhe datës kur pasqyrat financiare janë të autorizuara për t'u publikuar. Dy lloje të ngjarjeve mund të identifikohen, dmth.

- (a) -Ngjarjet korrigjuese- janë ato ngjarje që ofrojnë dëshmi të kushteve që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese
-Ngjarjet jo korrigjuese- janë ato ngjarje që tregojnë kushtet që kanë lindur pas periudhës raportuese

(3 pikë)

- (b) Sipas paragrafit 19 të SNK 10, nëse një kompani merr informacion pas periudhës raportuese rreth kushteve që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese, ajo do të azhurnojë informacionet shpjeguese që lidhen me këto kushte.

(2 pikë)

Pjesa B

- (i) Sipas paragrafit 11 të SNK 10, kjo është një ngjarje jo-korrigjuese. Rënia në vlerën e drejtë normalisht nuk lidhet me gjendjen e investimeve në fund të periudhës raportuese, por pasqyron rrethanat që kanë ndodhur më pas. Në mënyrë të ngjashme, kompania nuk i përditëson shumat e shpalosura për investimet në fund të periudhës raportuese, megjithëse mund të ketë nevojë të japë informacion shpjegues shtesë
- (ii) Sipas paragrafit 9 (c) të SNK 10, kjo është një ngjarje korrigjuese. Përcaktimi pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar të kostos së pasurive të blera para përfundimit të periudhës raportuese është një ngjarje korrigjuese pas periudhës raportuese dhe ngjarja korrigjuese duhet të njihet në pasqyrat e saj financiare për vitin përkatës të përfunduar. Prandaj, kostoja e plotë e automjetit duhet të pasqyrohet në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016.
- (iii) Sipas paragrafit 9 (a) të SNK 10, kjo është një ngjarje korrigjuese. Ngjarja është zhvilluar gjatë periudhës raportuese dhe përfundimi i çështjes gjyqësore pas periudhës raportuese konfirmon se ekziston një detyrim aktual në fund të periudhës raportuese. Prandaj, provizioni i mëparshëm duhet të kthehet dhe paratë e marra për pagesat ligjore duhet të thehen me çdo shpenzim ligjor që Okton shpk ka dhënë për të mbrojtur rastin në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016.
- (iv) Sipas paragrafit 9 (b i) të SNK 10, kjo është një ngjarje korrigjuese. Marrja e informacionit pas periudhës raportuese që tregon se një pasurie i ka rënë vlera në fund të periudhës raportuese, për shembull falimentimi i një klienti që ndodh pas periudhës raportuese zakonisht konfirmon se një humbje ka ekzistuar në fund të periudhës raportuese për një llogari të arkëtueshme. Prandaj, Okton shpk duhet të shlyejë shumën si një borxh të keq në pasqyrat e tij financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016.

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutem të më kontaktoni.

(15 pikë)

Sinqerisht,

Kontabilisti Financiar

[Total: 20 Pikë]

Problemi 4

Në vijim janë ekstraktet e pasqyrave financiare të kompanisë Marta shpk:

Bilanci i Gjendjes më 31 dhjetor	2014	2015
	€'000	€'000
PASURITË		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Toka	40,000	60,000
Fabrika dhe pajisjet	30,000	50,000
Orenditë	<u>48,500</u>	<u>120,000</u>
	118,500	230,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	22,750	73,250
Llogaritë e arkëtueshme	14,350	22,900
Paraja e gatshme	<u>15,250</u>	<u>21,300</u>
	52,350	117,450
TOTAL PASURITË	170,850	347,450
Ekuiteti dhe Detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	85,000	120,000
Premia	30,000	45,000
Rezerva e rivlerësimit		20,000
Rezerva e përgjithshme	9,500	9,500
Fitimet e mbajtura	<u>17,300</u>	<u>23,750</u>
	141,800	218,250
Detyrimet afatgjata		
7% Obligacione 2018		75,000
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme	16,700	41,400
Overdrafti bankar	3,950	2,650
Tatimi i pagueshëm	<u>8,400</u>	<u>10,150</u>
	<u>29,050</u>	<u>54,200</u>
Total Ekuiteti dhe Detyrimet	170,850	347,450

Ekstrakt i P/A për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015:

	€'000
Fitimi neto para tatimit	32,950
Tatimi	<u>11,500</u>
Fitimi neto pas tatimit	21,450

Informatat shtesë janë në dispozicion për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015

- Fabrika dhe pajisjet me vlerë neto në libra prej €5,000,000 ishte shitur për €4,000,000.
- Fabrika e re ishte blerë për €32,500,000.
- Orenditë me vlerë në libra prej €8,500,000 ishin shitur për €9,000,000.
- Fabrika dhe pajisjet zhvlerësohen me 15% në vit me metodën e saldove zbritëse, ndërkaq shpenzimet e zhvlerësimit të orendive për vitin janë €10,000,000.
- Obligacionet ishin lëshuar më 01 janar 2015.
- Kompania gjatë vitit ka deklaruar dividendë, shuma duhet të gjindet.

Kërkohet:

Përgatitni për Marta pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015.

[Total: 20pikë]

Zgjidhja e problemit 4

Marta

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015

	€
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ	
Fitimi neto para tatimit	32,950
Rregullimet për:	
Zhvlerësimi (llog.1)	17,500
Shpenzimet e interesit (llog.2)	5,250
Fitimi në shitje të pasurive jo-qarkulluese (llog.3)	(500)
Humbja në shitje të pasurive jo-qarkulluese (llog.4)	1,000
Fitimi operativ para ndryshimeve të kapitalit të punës	56,200
Rritja në stoqe	(50,500)
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	(8,550)
Rritja në llogaritë e pagueshme	24,700
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga operacionet	21,850
Interesi i paguar (llog.2)	(5,250)
Tatimi i paguar (llog.5)	(9,750)
Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti operativ	6,850
Rrjedha e parasë nga aktiviteti investues	
Pagesat për blerjen e pasurive jo-qarkulluese (llog.6)	(122,500)
Pranimet nga shitja e pasurive jo-qarkulluese (llog.7)	13,000
Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti investues	(109,500)

Rrjedha e parasë nga aktiviteti financues	
Emetimi i aksioneve	50,000
Emetimi i obligacioneve	75,000
Dividenda e paguar (llog.8)	(15,000)
Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti financues	110,000

Rrjedha e keshit gjatë vitit	7,350
Keshi dhe ekuivalentët e tij në fillim të periudhës (llog.9)	11,300
Keshi dhe ekuivalentët e tij në fund të periudhës (llog.10)	18,650

Llogaritja 1: Zhvlerësimi

Fabrika dhe pajisjet	
Vlera në fillim të vitit	30,000
Shitja	(5,000)
Shtimet (blerjet)	32,500
	57,500
Vlera më 31 dhjetor 2008	50,000
Zhvlerësimi	7,500

Fabrika dhe pajisjet

Saldo ne fillim 30,000	Shitja 5,000
Blerjet 32,500	Zhvleresimi (shifer balancuese) 7,500

Saldo ne fund 50,000

Total zhvlerësimi	
Fabrika dhe pajisjet	7,500
Orenditë	<u>10,000</u>
	17,500

Llogaritja 2: Shpenzimet e interesit

$$75,000 \times 7\% = 5,250$$

Llogaritja 3: Fitimi nga shitja e pasurive jo-qarkulluese

VNT e orendive të shitura	8,500
Shitja	9,000
Fitimi në shitje	500

Llogaritja 4: Humbja nga shitja e pasurive jo-qarkulluese

VNT e pajisjeve të shitura	5,000
Shitja	4,000
Humbja në shitje	(1,000)

Llogaritja 5: Tatimi i paguar

Detyrimi në fillim të vitit	8,400
Shpenzimet e tatimit gjatë vitit	11,500
	19,900
Detyrimi aktual në fund të vitit	10,150
Shuma e paguar [19,900 - 10,150]	9,750

Llogaritja 6: Pagesat për blerjen e pasurive jo-qarkulluese

Orenditë

Vlera në fillim të vitit	48,500
Shitja e orendive	(8,500)
Zhvlerësimi	(10,000)
	30,000
Vlera aktuale më 31/12/08	120,000

Orenditë e blera [120,000 - 30,000]	90,000
-------------------------------------	--------

Total pasuritë jo-qarkulluese të blera

Orenditë	90,000
Fabrika	32,500
	122,500

Llogaritja 7: Pranimet për shitjen e pasurive jo-qarkulluese

Orenditë	9,000
Fabrika	4,000
	13,000

Llogaritja 8: Dividenda e paguar

Fitimi i mbajtur në fillim	17,300
Fitimi i vitit	21,450
Fitimi i mbajtur në fund	(23,750)
	15,000

Llogaritja 9: Keshi dhe ekuivalentët e tij në fillim të periudhës

Saldo e parasë së gatshme	15,250
Overdrafti Bankar	(3,950)
	11,300

Llogaritja 10: Keshi dhe ekuivalentët e tij në fund të periudhës

Saldo e parasë së gatshme	21,300
Overdrafti Bankar	(2,650)
	18,650

Problemi 5

Z. Tomor, tregtar individual, ka kërkuar nga ju që të përgatitni llogarinë kontrolluese të të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të siguroni që saldot në fund të llogarive kontrolluese të të arkëtueshmeve dhe pagueshme barazohen me saldot në fund të listave individuale të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Aktualisht saldot në fund më 31 dhjetor 2018 janë si në vijim:

	€
Llogaria Kontrolluese e të arkëtueshmeve	126,845
Llogaria Kontrolluese e të pagueshmeve	103,240
Lista individuale e të arkëtueshmeve	123,589
Lista individuale e të pagueshmeve	104,476

Gjatë investigimit janë zbuluar detajet e mëposhtme:

- (i) Një kundër-hyrje (regjistrim kontra) prej 3,250€ nuk është përfshirë në asnjërën prej llogarive kontrolluese.
- (ii) Borxhi i keq në vlerë prej 1,680€ është shlyer nga lista individuale por nuk është përfshirë në llogarinë kontrolluese të të arkëtueshmeve.
- (iii) Libri i shitjeve ditore është mbivlerësuar në vlerë prej 890€ dhe kjo nuk është reflektuar në llogarinë kontrolluese.
- (iv) Kthimet e blerjeve tek furnitori z.Gramos në vlerë prej 256€ nuk janë reflektuar në llogarinë kontrolluese.
- (v) Një faturë me vlerë prej 981€ për klientin z.Taulant është regjistruar në librin e shitjeve ditore sikurse 891€.
- (vi) Saldo e detyrimit ndaj furnitorit z.Shanel në vlerë prej 1,248€ nuk ishte përfshirë në listën individuale.
- (vii) Një pagesë e pranuar nga z.Fitim në vlerë prej 2,864€ ishte regjistruar gabimisht si kredi tek llogaria e furnitorit z.Fiton. Pagesa ishte regjistruar në mënyrë korrekte në llogarinë kontrolluese.
- (viii) Mallrat e blerë nga furnitori z.Vedat në vlerë prej 3,126€ janë lënë jashtë nga llogaria kontrolluese përkatëse.
- (ix) Borxhi i keq i rikthyer (rikuperuar) në vlerë prej 300€ në lidhje me z.Kena nuk është përditësuar në listën individuale por është përfshirë në llogarinë kontrolluese.

Kërkohe:

- (a) Bazuar në informatat e ofruara më sipër:
 - (i) Përgatitni llogarinë kontrolluese të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018. (10 pikë)
 - (ii) Përgatitni raportin e harmonizimit të listave individuale me llogaritë kontrolluese të përmirësuara të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018. (7 pikë)
- (b) Përshkruani arsyet pse llogaritë kontrolluese janë të rëndësishme për një ndërmarrje (3 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja e problemit 5

Debi	Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve e z.Tomor	Kredi
Saldo e pakorrigjuar	126,845	
Gabimi në librin e shitjeve ditore (981 - 891)	90 Kontra regjistrimet	3,250
	Borxhi i keq i shlyer	1,680
	Libri i shitjeve ditore	890
	Saldo balancuese	121,115
	126,935	126,935
Saldo e korrigjuar	121,115	-

Debi	Llogaria kontrolluese e të pagueshmeve e z.Tomor	Kredi
------	--	-------

	Saldo në fillim	103,240
Kontra regjistrimet	3,250	Blerjet - z.Vedat
Kthimet e blerjeve - z.Gramos	256	3,126
	<u>106,366</u>	
Saldo balancuese		106,366
	Saldo e korrigjuar	102,860
		TOTAL PIKËT
		10.00

Lista Individuale e të arkëtueshmeve

Saldo e pakorrigjuar	123,589
Gabimi në librin e shitjeve ditore (981 - 891)	90
Pagesa e pranuar - z.Fitim	- 2,864
Borxhi i keq i rikuperuar	300
Saldo e korrigjuar	121,115

Lista individuale e të pagueshmeve

Saldo e pakorrigjuar	104,476
Saldo e pa përfshirë e z. Shanel	1,248
Pagesa e pranuar - z.Fitim	- 2,864
Saldo e korrigjuar	102,860

TOTAL PIKËT**7.00**

(b)

- Llogaritë kontrolluese sigurojnë kontroll mbi saktësinë e regjistrimeve të bëra në llogaritë individuale të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Ekziston mundësia që të bëhen gabime gjatë regjistrimit të të dhënave, sepse mund të ekzistojnë me qindra regjistrime që duhet të bëhen. Mund të bëhen gabime të ngatërrimit të llogarive (transponim). Disa regjistrime mund lihen krejtësisht jashtë (të mos përfshihen) dhe si rezultat i kësaj një faturë ose transaksion i pagesës nuk do të paraqitet në llogaritë e librit kryesor e që duhet të paraqitet. Duke krahasuar totalët e llogarive kontrolluese të të arkëtueshmeve / të pagueshmeve me totalët e listave individuale të llogarive personale të të arkëtueshmeve / të pagueshmeve, është e mundshme të identifikohen gabimet të cilat janë bërë.
- Llogaritë kontrolluese gjithashtu ndihmojnë në vendndodhjen e gabimeve kur regjistrimet bëhen në baza ditore, javore apo madje edhe mujore. Nëse personi dështon të regjistrojë një faturë ose një pagesë në llogarinë personale ose bënë një gabim të ngatërrimit të llogarive (transponim), do të ishte një detyrë e vështirë për të përcaktuar vendndodhjen e gabimit ose gabimin në fund të vitit. Mirëpo, duke përdorur llogarinë e kontrollit, krahasimin me listat individuale të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve që mund të bëhet çdo javë apo muaj, gabimi do të gjendet shumë më shpejt se sa nëse llogaritë kontrolluese nuk do të ekzistonin fare.
- Kur ekziston një ndarje e detyrave, llogaritë kontrolluese ofrojnë një kontroll të brendshëm. Personi i cili regjistron hyrjet në llogaritë kontrolluese do të veprojë si një kontrollues në detyrat e personave të tjerë të cilët e kanë për detyrë të regjistrojnë të dhënat në llogaritë e të arkëtueshmeve / të pagueshmeve.
- Për të siguruar saldot e të arkëtueshmeve / të pagueshmeve më shpejt për krijimin e bilancit vërtetues ose pasqyrën e pozitës financiare, mund të ekstraktohet si një saldo e vetme më shpejt dhe më thjesht në krahasim me saldot individuale të llogarive të tjera të të arkëtueshmeve / të pagueshmeve.

(3 pikë)

[Total: 20 pikë]